# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475394**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Greqia "turpëron" Gjermaninë dhe merr kreun e grupit |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394578.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 08:11:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 08:03:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 28 shtator 2026, 08:02:00 UTC → 28 shtator 2026, 08:04:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `35b3b891b61728071ded44d36e3820f9b28bdcce97da4b70a00e3b146010b20a` |
| TEKSTI | `e9d6a0b4f50b8f2a69374338004770bf54a3149e8e7fe4186bdf6dcda9153fab` |
| PAMJA | `5ddf4cb2ccdbd487a65fcfdaba366783f9417c126832507eaec06b9640b09dd1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `05a56b483983b758669dbcc7e2b79a27cc2fe63f7e0972f60cfa0e7a5ee6f287` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/05a56b483983b758669dbcc7e2b79a27cc2fe63f7e0972f60cfa0e7a5ee6f287`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Greqia “turpëron” Gjermaninë dhe merr kreun e grupit

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 28.09.2026, 10:03

Share Share



Greqia shkakton surprizën e madhe në Hamburg, duke mposhtur Gjermaninë me rezultatin 1-0 në ndeshjen e Nations League. Skuadra helene u bë protagoniste e një mbrëmjeje dramatike, ndërsa heroi i fitores ishte Kourbelis, autor i golit vendimtar, dhe portieri Tzolakis, i cili me pritjet e tij mbajti të paprekur portën greke.

Pjesa e parë u mbyll pa gola, 0-0, me Gjermaninë që edhe pse kontrolloi më shumë topin, nuk arriti të bindte në lojën e saj. Rastin e parë të rrezikshëm e pati Greqia me Karetsas, që provoi me një goditje nga distanca. Më pas, gjermanët morën kontrollin e lojës dhe rrezikuan me Adeyemin, i cili fillimisht dërgoi topin mbi traversë, ndërsa pak më vonë u ndal nga një ndërhyrje e Tzolakis pas një aksioni spektakolar.

Edhe në pjesën e dytë Gjermania u hodh menjëherë në sulm dhe iu afrua golit me Conte’, por sërish në skenë doli Tzolakis.

Kur pritej që presioni gjerman të sillte golin, ndodhi e kundërta. Në minutën e 73-të, Greqia goditi në momentin e duhur. Kourbelis shënoi golin e avantazhit 1-0, duke i ngrirë tifozët në Hamburg.

Gjermania kërkoi me çdo kusht barazimin dhe në minutën e 80-të iu afrua me Gnabry, por Tzolakis ishte sërish në vendin e duhur për të shpëtuar portën e tij.

Në minutat e fundit, Greqia u mbrojt me shumë sakrificë dhe arriti të ruajë avantazhin deri në vërshëllimën finale. 1-0 për grekët, që marrin fitoren e dytë në Nations League dhe ngjiten në krye të Grupit A2.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.